

UNIVERSITETI I ARTEVE
BORDI I ADMINISTRIMIT

VENDIM

Nr. 13, datë 02.07.2021

MBI

“MIRATIMIN PËR PËRJASHTIM/REDUKTIM/BURSË NGA TARIFA VJETORE E SHKOLLIMIT TË STUDENTËVE TË CIKLIT TË PARË BACHELOR DHE MASTER, PËR VITIN AKADEMIK 2020-2021, NË FAKULTETIN E ARTEVE TË BUKURA DHE FAKULTETIN E MUZIKËS, TË UNIVERSITETIT TË ARTEVE”

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 për “Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 269, date 29.03.2017 “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit” (i ndryshuar)etj.; urdhrin e Rektorit të Universitetit të Arteve nr. 56, datë 13.11.2020 mbi “Ngritjen e grupit të punës për pranimin e aplikimeve të studentëve, të cilët përjashtohen/reduktohen nga tarifa vjetore e shkollimit, për vitin akademik 2020-2021, në Universitetin e Arteve”,si dhe bazuar në shkresën me nr. 22, datë 29.03.2021 Fakultetit të Arteve të Bukura dhe shkresës me nr.86 25.05.2021 nga Fakulteti i Muzikës, Bordi i Administrimit pasi diskutoi rreth Relacionit në lidhje me kërkesat e studentëve, paraqitur nga Administrator i UART znj. Alma Sinanaj dhe duke u bazuar ne aktet e dala për këtë qëllim dhe pasi e diskutoi,

V E N D O S I :

1. Miratimin për bursë/përjashtimin/reduktimin nga tarifa vjetore e shkollimit, të studentëve sipas lidhjes bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi, Fakulteti i Arteve të Bukura si dhe Fakulteti i Muzikës në Universitetin e Arteve dhe Drejtoria Ekonomike.
3. Publikimin e vendimit në faqen zyrtare (internet) të Universitetit të Arteve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



BORDI I ADMINISTRIMIT I UNIVERSITETIT TË ARTEVE

Risena Xhaja (Kryetar)

Prof. Besnik Bisha (Anëtar)

Prof. Arben Basha (Anëtar)

Aida Martiro (Anëtar)

Vladimir Llakaj (Anëtar)

Prof. Bujar Kapexhiu (Anëtar)

Lorene Vangjeli (Anëtar)

